



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 620

NR. VENDIMI 1372



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR

TIRANË

Nr.

620

Regj.Them.

Nr. 1372 Vendimi

V E N D I M
"NE EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë nga

GJYQTAR : ARDIAN KALIA

asistuar nga sekretare gjyqësore Beglie NURA, me pjesëmarrjen e Prokurorisë së rrethit gjyqësor Tiranë, e përfaqësuar nga **Prokuror *****, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, sot me datë 28/04/2016, përfundoi shqyrtimin e çështjes penale, e cila i përket:

I dëmtuar Akuzues:

***, i biri i *** dhe i ***, dtl. ***, lindur dhe banues ne ***, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, me përfaqësues në gjykim Av. ***, me Nr. *** Liçense dhe NIPT ***, Anëtar i Dhomës së Avokatëve Tiranë.

KUNDËR

Të Akuzuarit:

Personit juridik "**", me administrator ***, me NIPT ***, me adresë ***, i përfaqësuar në gjykim me autorizim nga Zj. ***.**

Akuzuar :

Për kryerjen e veprës penale "*Riprodhimi pa të drejtë i veprës së tjetrit*", të parashikuar nga neni 149 i Kodit Penal.

Baza Ligjore:

Nenet 59, 60 të K.Pr.Penale, lidhur me nenet 45 e 149 të Kodit Penal, Ligji Nr.9380, dt.28/04/2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, Ligji 9754, dt.14/06/2007, “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”.

Gjykata pasi shqyrtoi çështjen, dëgjoi palët në diskutimin përfundimtar, të cilët kërkuan, respektivisht:

I Dëmtuari Akuzues: Deklarimin fajtor të të pandehurit “***” për veprën penale “Riprodhimi pa të drejtë i veprës së tjetrit”, të parashikuar nga neni 149 i Kodit Penal dhe në bazë të këtij neni dënimit e tij me minimumin e masës së dënimit të parashikuar në ligj si dhe shpërblimin e dëmit në masën e përcaktuar në aktin e ekspertimit të hartuar në këtë gjykim.

Përfaqësuesja e të Akuzuarit personit juridik “***” kërkoi, rrëzimin e kërkesës;

Prokuroria: Rrëzimin e kërkesës së paraqitur nga ana e kërkuesit si të pambështetur në ligj dhe prova;

Gjykata, pasi dëgjoi konkluzionet e palëve në diskutimin përfundimtar, shqyrtoi provat dhe çështjen në tërësi:

VËREN

1. Se i dëmtuari Akuzues shtetasi ***, ka vënë në lëvizje Gjykatën e Rrethit Gjyqsor Tiranë me anën e kërkesës së saj, me referencë dispozitat e cituara në bazë ligjore në kërkesë, kundër të akuzuarit “***”, duke e akuzuar atë se ka kryer veprën penale të “Riprodhimi pa të drejtë i veprës së tjetrit”, të parashikuar nga neni 149 i Kodit Penal.

2. Gjykata çmon paraprakisht të theksojë se, Meqenëse nuk u arrit që çështja të zgjidhej me pajtim, bazuar në nenin 338 të K.Pr.Penale, vendosi që çështja të kalojë për gjykim duke njoftuar dhe siguruar edhe pjesmarjen e përfaqësuesit të organit të Prokurorisë.

3. Nga ana e palëve në proces nuk pati pretendime lidhur me kompetencën apo juridiksionin e Gjykatës si edhe vetë Gjykata nuk konstatoi kryesisht shkaqe papajtueshmërie për gjykimin e kësaj çështjeje. Për shkak të masës së dënimit të parashikuar posaçërisht nga dispozitën e ligjit material penal (neni 149 i Kodit Penal) për të cilën akuzohet i akuzuari, në kuptim të nenit 13 të K.Pr.Penale, gjykimi i kësaj çështjeje u zhvillua nga gjyqtar i vetëm.

4. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes penale në ngarkim të të akuzuarit “****”, rezultuan të provuara faktet e rrethanat që vijnë:

5. I dëmtuari akuzues *** është autor i veprës “*Videogram 20 shkurti, renia e bustit të Enver Hoxhes*”, për të cilën mbështetur në ligjin nr. 9380, dt. 28.04.2005, si dhe VKM nr. 232, dt.19.04.2006, ka certifikuar regjistrimin e të drejtës së autorit për veprën në fushën “Krijimet kinematografike dhe krijimet e tjera audiovizuale”, me Çertifikatën e regjistrimit date 31.10.2007.

6. Nga ana e të dëmtuarit akuzues u pretendua se personi juridik Televizioni “****”, në kundërshtim me Ligjin nr. 938, dt. 28.04.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, si dhe me VKM nr. 232, dt.19.04.2006 “Për krijimin e funksionimin e ZSHDA”, në datën 20 shkurt 2015, në edicionin e lajmeve, ka transmetuar pa autorizimin ose lejen e tij “Videograma 2 shkurti, rënie bustit të Enver Hoxhes”. I dëmtuari akuzues pretendon se, në këtë mënyrë, nga ana e palës së akuzuar i është cënuar e drejta e autorit mbi këtë krijim të tij si dhe pala e akuzuar duhet të përgjigjet penalisht, duke shpërblyer gjithashtu dëmin që ai pretendon se i ka ardhur nga ripriodhimi pa të drejtë i veprës së tij.

7. Sipas të dëmtuarit akuzues, pala e akuzuar e ka kryer veprën penale të parashikuar nga neni 149 i K.Penal. Fajësia e të akuzuarit personit juridik Televizioni “****”, për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 149 i K.Penal, sipas të dëmtuarit akuzues, provohet nga Çertifikata e regjistrimit e dt. 31.10.2007, të së drejtës së autorit *** për veprën “Videogram 20 shkurti renia e bustit të Enver Hoxhes”, materiali filmik i pasqyruar në një CD-DVD si dhe korrespondenca me shkrim me palën e akuzuar, me anën e të cilës i ka kërkuar ta dëmshpërblejë civilisht jashtëgjyqësisht.

8. Nga përmbajtja e aktit, Çertifikatë e regjistrimit e dt. 31.10.2007, rezulton se i dëmtuari akuzues *** njihet si autor i vetëm i veprës, i cili në mënyrë ekskluzive gëzon të gjitha të drejtat për ta shfrytëzuar atë. Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi se, i dëmtuari akuzues *** me kërkesën e datës 09.01.2015, nëpërmjet avokatit të tij, i është drejtuar personit të akuzuar, duke e vene në dijeni për ekzistencën e autoresisë së veprës, duke i kërkuar gjithashtu që të dëmshpërblejë në shumën *** Euro.

9. Gjithashtu, rezultoi e provuar gjatë shqyrtimit gjyqësor se, me shkresë të datës 20/03/2015, i është drejtuar sërish palës së akuzuar, duke i kërkuar lidhjen e një marrëveshjeje bashkëpunimi me shkrim për shfrytëzimin në të ardhmen të veprës së tij, si dhe duke e paralajmëruar për pasojat ligjore që do të kishte nëse do të vazhdonte shkeljen.

10. Nga ana e të dëmtuarit akuzues, u invokua gjatë shqyrtimit gjyqësor një shembull për tu marrë si model i cili, sipas të dëmtuarit akuzues, faktori edhe mënyrën se si duhet të shfrytëzohet vepra e tij dhe konkretisht, kontrata nr. ***, dt.21.06.2013 e lidhur midis ***, perfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm dhe autoriteti të vepres “*Rënia e monumentit të Enver Hoxhës*”. Nga kjo kontratë e lidhur me një prej televizioneve më të vjetër në Shqipëri me eksperiencë dhe jetëtrajecare në fushën audiovizuale, është konfirmuar dhe njohur autorësia përpos Z.SH.D.A. ku përcaktohet mënyra e drejtë e shfrytëzimit të vepres, autorizimet për përdorim tek të tretë apo mënyra e shpërblimit, të gjitha këto të drejta ekskluzive të autorit.

11. Sipas personit të dëmtuar ky transmetim pa autorizim apo pa lejen e tij, përbën veprë penale të kundërvajtjes parashikuar nga neni 149 i K.Penal. Gjithashtu nga ana e përfaqësuesit të të dëmtuarit akuzues u argumentua se përfaqësuesi i personit të akuzuar, pranoi që “Videogrami 20 shkurti, rënia e bustit të Enver Hoxhës” është transmetuar nga “****”, me pretendimin se është gjetur në portale të tjera, por kjo nuk përbën shkak për ta larguar nga përgjegjësia ligjore. Veç përgjegjësive penale të pershkruar me sipër, personi juridik Televizioni “****”, sipas përfaqësuesit të të dëmtuarit akuzues, duhet të përgjigjet edhe për dëmin e shkaktuar nga kryerja e kësaj veprë penale, në masën në të cilën është shprehur ekspertja e caktuar në këtë gjykim.

12. Nga ana e përfaqësueses së Personit juridik Televizioni “****”, u kërkua rrëzimi i kërkesës pasi, fakti nuk përbën veprë penale. Sipas saj, videogrami objekt gjykimi nuk mund të jetë një veprë letrare, po ashtu nuk mund të jetë as një veprë muzikore ose shkencore. Mbetet për tu parë nëse është apo jo veprë artistike. Sipas përcaktimeve të bëra në Ligjin nr. 9380, dt. 28.04.2005, me veprë artistike do të kuptojmë “Cdo krijim origjinal, intelektual i një personi fizik, i materializuar, pavarësisht nga forma a mënyra e të shprehurit, që ka për qëllim të preke ndjesitë e njeriut”.

13. Videogrami objekt gjykimi nuk është dhe nuk mund të cilësohet veprë artistike dhe në këto kushte nuk jemi përpara konsumimit të vepres penale të parashikuar nga neni 149 i K.Penal. Sipas përfaqësueses së të akuzuarit, kjo video është marrë nga një faqe interneti me famë botërore si është “You Tube”, faqe kjo që ka nepermbajtje të saj me miliona video të aksesueshme nga gjithkush. Subjekti juridik “****”, e ka përdorur këto videogramë për të transmetuar në edicionin e lajmeve me qëllim informimi dhe pa asnjë lloj dobie në emër të subjektit juridik. Për më tepër që filmimi i këtij momenti historik, i cili është transmetuar nga “****”, vazhdoi argumentimin përfaqësuesi i të akuzuarit, sic rezulton nga CD, është marrë nga Instituti Italian *** dhe jo nga i dëmtuari akuzues, për rrjedhojë edhe legjitimiteti i të dëmtuarit akuzues në këtë proces, në vlerësimin tonë si pale e dëmtuar akuzuese sipas nenit 58 e vijues nuk

qendron. Gjithashtu nga ana e përfaqësueses te subjektit te akuzuar u pretendua qe nuk kane marre asnje shkrese nga ana e autorit te videogramit, persa i perket te drejtes se autorit mbi videon.

14. Nga ana prokurorit *** u kerkua rrezimi i kerkeses, pasi ne rastin konkret videogrami nuk eshte nje vepër artistike, vepër letrare, vepër muzikore dhe as nje vepër shkencore. Videogrami nuk mund te jete nje vepër arstitike pasi nuk eshte nje krijim origjinal i nje personi. Ai eshte nje filmim i xhiruar me kamera, qe ka fiksuar momentin kur eshte rrezuar busti i Enver Hoxhes.

15. Gjykata çmon të theksojë se, mbi kërkesën e palës së dëmtuar akuzuese dhe për një hetim gjyqsor sa më të plotë e të paanshëm në lidhje me çështjen, Gjykata caktoi një eksperte të vlerësimit të dëmeve që vijnë nga përdorimi i veprave të kësaj natyre, të cilës i caktoi disa detyra, në lidhje me veprën “*Videograma 20 shkurti, rënia e bustit te Enver Hoxhës*”.

16. Në përfundim, nga ana e ekspertës *** u konkludua për praninë e një dëmi nga përdorimi i kësaj vepre, në shumën *** lekë, si vlerë e konsideruar si spot për të gjithë transmetimin, ose në vlerë neto *** lekë. Pala e dëmtuar akuzuese, nëpërmjet përfaqësuesit të posaçëm të tij, kërkoi në konkluzionet përfundimtare që krahas përgjegjësisë penale për riprodhimin pa të drejtë të veprës së tij, pala e akuzuar të detyrohej civilisht, për ta dëmshpërblyer të dëmtuarin akuzues në shumën e përcaktuar nga an e ekspertës.

17. Në përfundim, në analizë të pretendimeve e prapsimeve të parashtruara nga ana e palëve në lidhje me kërkimet e vëna në the,el të kësaj kërkesë, të provave të cilat iu nënshtruan shqyrtimit gjyqsor, në interpretim të kuadrit ligjor i cili përcakton rastet e përgjegjësisë penale për përdorimin apo riprodhimin pa të drejtë të veprave që përfshihen në rrethin e veprave të mbrojtura për efekt të të drejtës së autorit, Gjykata çmon se i akuzuari Televizioni “***”, duhet te deklarohet i pafajshëm per vepren penale te “*Riprodhimit pa te drejte te veprës se tjetrit*”, të parashikuar nga neni 149 i K.Penal.

18. Neni 149 i K.Penal, parashikon se: “*Riprodhimi tërësisht ose pjesërisht i vepres letrare, muzikore, artistike ose shkencore qe i perket nje tjetri ose perdorimi i tyre pa pelqimin e autorit, kur kane shkelur te drejtat vetjake e pasurore te tij, përbën kundravajtje penale dhe denohet me gjobe ose me burgim gjer ne dy vjet*”.

19. Kjo dispozitë, mbron marrëdhëniet juridike te vendosura per te mbrojtur paprekshmërinë e te drejtes se autorit nga veprimet ose mos veprimet kriminale. Nga ana objektive vepra penale kryhet me ane te riprodhimit, te vepres qe do te thote ribotim me cdo lloj mjeti, fotokopjim riprodhim me dore etj., te vepres

letrare, muzikore, arstistike ose shkencore.

20. Gjate gjykimit u provua se me Çertifikatën e regjistrimit dt.31.07.2007, nga Zyra Shqiptare per te Drejtat e Autorit, eshte certifikuar regjistrimi i se drejtes se autorit ***, per vepren “Videogram “20 shkurti, renia e bustit te Enver Hoxhes”. Nga ana e te dëmtuarit akuzues u pretendua se transmetimi i kesaj vepre nga ana e Televizionit “****”, pa lejen e tij si autor, përbën vepren penale te parashikuar nga neni 149 i K.Penal.

21. Gjykata vëren, se neni 149 i K.Penal merr ne mbrojtje nje kategori te caktuar te veprave te autorit, qe jane veprat letrare, muzikore, artistike ose shkencore. Ne nenin 4, te Ligjit nr. 9380, dt. 28.04.2005 “Per te drejten e autorit dhe te drejtat e tjera te lidhura me te”, jepen perkufizime te vepres artistike, vepres letrare, vepres muzikore, vepres arkitekturore, vepres teatrore, vepres dramatike, vizatim, gravure, videogramit, skulptures, etj. Videogrami, objekt i ketij gjykimi, në kuptim të nenit 149 të Kodit Penal, nuk përbën vepër letrare, as muzikore dhe as shkencore.

22. Kategoria tjetër qe merret ne mbrojtje nga neni 149 i K.Penal ka te beje me riprodhimin teresisht ose pjeserisht *te vepres artistike*. Ne nenin 4, pika 33, te Ligjit nr. 9380, dt. 28.04.2005 “Per te drejten e autorit dhe te drejtat e tjera te lidhura me te”, percaktohet se: “*...Vepër arstistike eshte cdo krijim origjinal, intelektual i nje personi fizik i materializuar, pavaresisht nga forma a menyra e te shprehurit, qe ka per qellim te preke ndjesite e njeriut*”. E thënë më qartë, vepër artistike do te quhet çdo krijim origjinal, intelektual i nje personi fizik, ndersa “*Videogrami “20 shkurti, renia e bustit te Enver Hoxhes”*”, objekt i ketij gjykimi eshte videogram, filmim i nje momenti historik dhe jo krijim origjinal i te dëmtuarit akuzues ***.

23. Nisur nga sa me siper, Gjykata duke u nisur nga perkufizimi qe i ben ligji vepres artistike çmon se “*Videogram 20 shkurti, renia e bustit te Enver Hoxhes*”, nuk eshte vepër artistike, pasi perkufizimi i videogramit percaktohet, po ne nenin 4 te te Ligjit nr. 9380, dt. 28.04.2005, pika 33 e ketij ligji, sipas te cilit: “*..videogram nenkupton mjedisin ku eshte fiksuar nje vepër audiovizuale e materializuar me ose pa kolone zanore, qe lejon percjelljen e riprodhimin e vepres...*”.

24. Gjykata vlerëson se, transmetimi i këtij videogrami nga ana e “****”, nuk përbën vepër penale ne vështrim te nenit 149 te K.penal, per sa kohe qe ne këtë nen nuk përmendet videogrami ne kategorinë e veprave te autoreve te mbrojtura nga ligji penal. E thënë ndryshe, ligjvënësi ka përcaktuar në mënyrë shteruese kategorinë e veprave të autoreve qe merren ne mbrojtje nga ligji penal (*letrare, muzikore, artistike ose shkencore*) dhe videogrami nuk përfshihet në rrethin e

këtyre veprave.

25. Nga ana tjetër, duke qene se videogrami ben pjese ne kategorine e veprave te autorit qe mbrohen nga ligji nr.9380 date 28.04.2005 “*Per te drejten e autorit dhe te drejatat e tjera te lidhura me te*”, i dëmtuari akuzues, nëse e çmon, mund ti drejtohet gjykatës civile duke paditur palën e akuzuar personin juridik “***”, në lidhje me shkeljen e të drejtës së autorit të pretenduar të shkelur prej tij, duke i kundrejtuar kërkitime të rendit civil palës së akuzuar. Gjykata çmon, se pala e akuzuar nuk mund të përgjigjet penalisht për faktin e atribuar nga ana e të dëmtuarit akuzues.

26. Për sa më lart u arsyetua, Gjykata çmon se, nga provat e administruara rezulton se nuk ndodhemi përpara veprës penale “*Riprodhimi pa të drejtë i veprës së tjetrit*”, parashikuar nga neni 149 te K.Penal, per shkak se fakti që i kundrejtohet të akuzuarit, nuk përbën vepër penale dhe në këto kushte, në respekt të nenit 388/b te K.Pr.Penale, i akuzuari personi juridik “***”, duhet te deklarohet i pafajshëm për sa akuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, duke u bazuar në nenet 379, 384, 388/b të K.Pr.Penale

VENDOSI

- Deklarimin e pafajshëm të të akuzuarit Personit juridik “***”, për veprën penale “*Riprodhimi pa të drejtë i veprës së tjetrit*”, të parashikuar nga neni 149 i kodit penal.
- Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen të dëmtuarit akuzues.
- Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 10 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes së vendimit.
- **U shpall në Tiranë, sot me dt. 28/04/2016.**

**SEKRETARE
GJYQTAR
BEGLIE NURA
ARDIAN KALIA**